

Nr. 58 Prot.
Tiranë, më 11. 11. 2025

Nr. 1942 Prot.
Tiranë, më 11. 11. 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

Universitetit të Arteve Tiranë, institucion publik i arsimit të lartë, i krijuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me **NIPT K51713024L** dhe seli në Rruga Bulevardi “ Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, i përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Erald Bakalli, (në vijim referuar si “UA”)

Dhe

Kolegjit Profesional të Lartë “Tirana Esthetics & Style School” (TESS), me emrin tregtar NLT Sh.p.k, me NUIS L81918019K, me seli në Tiranë, Rruga Gjeneral Nikols, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Ferid Hudhri, (në vijim referuar si “TESS”).

Së bashku referuar si Palët dhe individualisht referuar si Pala.

Palët, në bazë të kuadrit ligjor në fuqi dhe me dëshirën e mirë për të zhvilluar bashkëpunim akademik dhe profesional me interes të përbashkët, bien dakord për sa vijon:


Neni 1 - Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e një bashkëpunimi institucional ndërmjet **Universitetit të Arteve dhe Kolegjit Profesional të Lartë “Tirana Esthetics & Style School”** në fusha të interesit të përbashkët akademik, profesional dhe shkencor.

– Bashkëpunimi do të përfshijë:

- Angazhimin e stafit akademik të Universitetit të Arteve në Kolegjin Profesional të Lartë TESS për realizimin e lëndëve në programet e studimit që TESS ofron, në përputhje me nenin 64, pika 2 të ligjit nr. 80/2015.
- Angazhimin e stafit akademik të TESS në Universitetin e Arteve për lëndët që ofron UA, në përputhje me nenin 64, pika 2 të ligjit nr. 80/2015.

- Organizimin e përbashkët të aktiviteteve akademike, projekteve dhe nismave të tjera që lidhen me fushat artistike dhe profesionale me interes për të dyja palët, sipas marrëveshjeve të veçanta.



- Përdorimin e bibliotekës së Universitetit të Arteve nga studentët dhe stafi akademik i Kolegjit Profesional të Lartë TESS, në përputhje me rregulloret përkatëse të Universitetit të Arteve.
- Interesa të tjera të përbashkëta ndërmjet palëve.

Neni 2 - Kohëzgjatja dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga përfaqësuesit ligjorë të palëve dhe mbetet në fuqi për afat të pacaktuar, përveçse nëse palët bien dakord ndryshe me shkrim.

Neni 3 - Përgjegjësitë e palëve

Palët angazhohen të bashkëpunojnë në frymën e respektit të ndërsjellë, duke respektuar dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi që rregullojnë arsimin e lartë dhe formimin profesional.

Çdo angazhim i stafit akademik, organizim aktiviteteve apo projekt i përbashkët do të formalizohet me marrëveshje ose protokolle shtesë që përcaktojnë detyrimet, afatet dhe kushtet specifike.

Palët mbajnë përgjegjësi për cilësinë dhe përmbushjen e detyrimeve që u takojnë sipas kësaj marrëveshjeje dhe akteve të tjera plotësuese.

Neni 4 - Ndërprerja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të ndërpritet nga cilado palë, me njoftim me shkrim të paktën 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara datës së ndërprerjes së planifikuar.

Marrëveshja mund të ndërpritet gjithashtu në rastet e forcës madhore, sipas përcaktimeve të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Pavarësisht ndërprerjes, çdo proces mësimor apo angazhim që ka filluar në kuadër të kësaj marrëveshjeje do të përfundojë në mënyrë të rregullt, duke garantuar mbylljen e plotë të detyrimeve përkatëse.

Neni 5 – Ndryshimet dhe shtesat

Çdo ndryshim, shtesë apo interpretim i kësaj marrëveshjeje do të bëhet vetëm me marrëveshje të përbashkët me shkrim ndërmjet palëve dhe do t'i bashkëngjitet si aneks kësaj marrëveshjeje, duke u bërë pjesë përbërëse e saj.

Neni 6 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet negociatave direkte midis përfaqësuesve të autorizuar të palëve.



Neni 7 – Dispozita përfundimtare

Kjo marrëveshje përbën dokumentin e plotë të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet palëve dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme me të njëjtin objekt.

Marrëveshja hartohet në dy (2) kopje origjinale, me të njëjtën vlerë ligjore, nga të cilat secila palë mban një (1) kopje.

Për Universitetin e Arteve të Republikës së Shqipërisë

Rektori

Prof. Dr. Erald Bakalli

(nënshkrimi dhe vula)



Për Kolegjin Profesional të Lartë “Tirana Esthetics & Style School” (TESS)

Rektori



Prof. Dr. Ferid Hudhri

(nënshkrimi dhe vula)

